



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

Nr. 2060 prot.

Elbasan, më 26.10.2020

VENDIM

Nr. 01, datë 26.10.2020

**"PËR
MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROCESIT MËSIMOR NË UNIVERSITETIN
E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" PËR VITIN AKADEMIK 2020-
2021"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të UE-së, Urdhrit të Ministrit të shëndetësisë dhe Mbrotjtjes Sociale Nr. 289 datë 04.05.2002 "Për miratimin e Udhëzuesit për masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore", Rregullores mbi masat sanitare për minimizimin e riskut nga COVID-19 në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", duke marrë në konsideratë propozimet e Fakulteteve të UE-së, numrin e studentëve, kapacitetet mjedisore, respektimin e masave higjieno-sanitare mbi parandalimin e përhapjes së Covid-19, Rektorati,


VENDOSI:


1. Procesi mësimor në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për vitin akademik 2020-2021 të zhvillohet i kombinuar në auditor dhe online në platformën Microsoft TEAMS.
2. Të miratojë propozimet e secilit fakultet për mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor për vitin akademik 2020-2021 për secilin program studimi dhe vit studimi.
3. Secili fakultet të marrë masa për të publikuar në faqen elektronike zyrtare përcaktimet e detajuara për mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor për secilin program studimi dhe vit studimi.
4. Ngarkohen Dekanët me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Skender TOPI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI EKONOMIK
DEKANATI

Nr. 231/1 prot.

Elbasan, me 26.10.2020

VENDIM

Nr. 12 datë 26.10.2020

"PËR
MËNYRËN ZHVILLIMIT TË PROCESIT MËSIMOR
NË FAKULTETIN EKONOMIK TË UE"

Në mbështetje të nenit 43 të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Statutit të UE, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.5, datë 30.01.2018, neni 19; "Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Universitetit të Elbasanit", miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr.22, datë 12.04.2020, neni 27; si dhe në zbatim të Vendimit të Rektoratit të UE nr.1, datë 26.10.2020 "Për mënyrën zhvillimit të procesit mësimor në Universitetin e Elbasanit "A.Xhuvani", për vitin akademik 2020-2021", Dekanati i Fakultetit Ekonomik, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2020,

VENDOSI:

1. Procesi mësimor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", për të gjitha programet e studimit, në të gjitha vitet, do të fillojë të zhvillohet në auditor, sipas planeve mësimore, duke respektuar orarin e miratuar.
2. Nëse gjatë zhvillimit të mësimit në auditor, do të konstatohet se numri i madh i studentëve e bën të pamundur respektimin e masave të distancimit, për ruajtjen nga rreziku i COVID-19, Dekanati do të miratojë ndryshimin e metodologjisë së zhvillimit të mësimit duke kaluar në mësimdhënien e kombinuar në auditor dhe on line.
3. Ky vendim i përcillet Rektoratit për procedura të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI
Prof.as.Dr.Imelda SEJDINI





2060/4
29.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Nr. 113/2. prot

Elbasan më 29.10.2020

V E N D I M

Nr. 11, datë 29.10.2020

Bazuar në shkresën e Rektoratit me nr. prot. 2060 datë 26.10.2020 për mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor në Universitetin e Elbasanit "A.Xhuvani", dekanati i FSHH-së

VENDOSI:

1. Procesi i mësimdhënies në FSHH të zhvillohet në auditor duke qenë se numri i studentëve në programet e Fakultetit është relativisht i vogël dhe mund të përballohet nga hapësirat që kemi në dispozicion.
2. Për të respektuar aktet rregullatore lidhur me masat dhe protokollet higjeno-sanitare mbi parandalimin e përhapjes së Covid -19, sipas rrethanave specifike që mund të krijohen në vijimësi, procesi mësimor mund të zhvillohet edhe online në platformën Microsoft TEAMS.

DEKANI

Prof.as.dr. Albert Riska





2069/1
28.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Nr. 105/1 prot.

Elbasan, më 26.10.2020

VENDIM

Nr. 10 datë 26.10.2020

PËR MËNYRËN E ZHVILLIMIT E MËSIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Në kuadër të masave anticovid, nisur edhe nga numri i madh i studentëve, FSHMT ka menduar që për vitin akademik 2020-2021 mësimi të zhvillohet i kombinuar online (pjesa e leksioneve) dhe në auditor (seminaret dhe laboratorët).

Për leksionet:

Viti i parë 3 javët e para do të zhvillojë në auditor duke shfrytëzuar sallat e leksioneve sipas një orari të përcaktuar duke patur parasysh distancimin fizik

Viti i dytë do të kthehet në auditor javën e IV deri javën e VI, për të zhvilluar leksionet

Viti i tretë do të kthehet në auditor javën e VII deri javën e IX për të zhvilluar leksionet

Për seminarët dhe laboratorët:

Të gjitha orët do të zhvillohen në auditor sipas një orari të hartuar posaçërisht duke shfrytëzuar sallat e leksioneve (aty ku është e mundur), ose duke e ndarë grupin me numër të kufizuar studentësh për të respektuar distancimin fizik në kuadër të masave anticovid.

DEKANI

Prof.as.dr.Shkelqim hidri





2060/5
29.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Nr. 304 prot.

Elbasan, më 29.10.2020

VENDIM

Nr. 14 datë 29 . 10. 2020

PËR

"MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROCESIT MËSIMOR NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË EDUKIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit të Elbasanit, Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 229, datë 04.05.2020 "Për miratimin e Udhëzuesit për masat ndaj Covid 19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore", Rregullores mbi masat sanitare për minimizimin e riskut nga Covid 19 në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", duke marrë parasysh propozimet e departamenteve të FSHE-së si dhe në zbatim të vendimit të Rektorit Nr. 01, datë 26.10.2020, numrit e studentëve, kapaciteteve mjedisore, respektimit të masave higjeno-sanitare mbi parandalimin e përhapjes së Covid 19, Dekanati i FSHE-së,

VENDOSI

1. Procesi mësimor në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, për vitin akademik 2020-2021 të zhvillohet i kombinuar në auditor dhe online në platformën Microsoft TEAMS, MOODLE.
2. Leksionet të zhvillohen online dhe seminarët në auditor në këto programe studimi:
 - a. Viti i tretë Bachelor në Punonjës Social;
 - b. Viti i parë dhe i dytë në Programin profesional 2 vjeçar "Edukator për fëmijët 0-3 vjeç";
 - c. Viti i parë, i dytë, i tretë Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte.
3. Të gjithë programet e tjera të zhvillojnë mësimin në auditor sipas orarit të përcaktuar.
4. Ngarkohet personeli akademik në zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof.as.dr. Elisabeta OSMANA





2060/3
29.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Nr. 266 prot.

Elbasan, më 29.10.2020

VENDIM

Nr. 30 Dt. 29.10.2020

**Për mënyrën e zhvillimit të mësimi në programet e studimit të
Fakultetit të Shkencave të Natyrës**

Në mbledhjen e Dekanatit të datës 26.10.2020 u vendos që mësimi në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të zhvillohet i kombinuar në auditore dhe online sipas përcaktimit të mëposhtëm :

- Për programin e studimit Bachelor në Biologji - Kimi mësimi do të zhvillohet në auditore për të tre vitet.
- Për programin e studimit Bachelor në Matematikë – Fizikë mësimi do të zhvillohet në auditore për të tre vitet.
- Për programin e studimit Bachelor në Matematikë -Informatikë mësimi do të zhvillohet në auditore për të tre vitet.
- Për programin e studimit Bachelor në Teknologjitë e Informacionit mësimi do të zhvillohet në auditor për vitin e parë, ndërsa për vitin e dytë dhe të tretë leksionet do të zhvillohen online, ndërsa seminarët dhe laboratorët do të zhvillohen në auditore.
- Për programin e studimit me karakter profesional në Teknologji Laboratori, Teknik Mjedis, Logjistikë dhe Mekatronikë mësimi do të zhvillohet në auditore për vitin e parë, ndërsa për vitin e dytë leksionet do të zhvillohen online, ndërsa seminarët dhe laboratorët do të zhvillohen në auditore.
- Për programin e studimit Master Profesional në Teknologjitë e Informacionit mësimi do të zhvillohet në auditor për vitin e parë, ndërsa për vitin e dytë leksionet do të zhvillohen online, ndërsa seminarët dhe laboratorët do të zhvillohen në auditore.
- Për programin e studimit Master i Shkencave në Mbrojtje Mjedis mësimi do të zhvillohet në auditore për të dy vitet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof. Dr. Sotir MALI

